



MATEMATIKË



KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES SË NXËNËSVE NË FUND TË CIKLIT TË TRETË TË SHKOLLËS FILLORE

UDHËZIM

KOHA PËR ZGJIDHJEN E TESTIT: 70 MINUTA.

Mjetet e punës: lapsi grafit dhe goma, stilolapsi, veglat gjeometrike.
Nuk lejohet përdorimi i llogaritësit elektronik (digitronit) dhe korrektorit.

Lexoni me kujdes udhëzimin.

Mos e hapni testin dhe mos filloni me zgjidhjen e detyrave pa ju dhënë leje mësimdhënësi. Testi përmban 15 detyra.

Gjatë punës mund të shfrytëzoni formulat që janë dhënë në faqen 4 dhe 5.

Lexoni me kujdes detyrat dhe mendohuni para se t'i zgjidhni ato. Nëse detyra ju duket tepër e vështirë, mos humbni shumë kohë në të, por tentoni ta zgjidhni detyrën tjetër në vazhdim. Në detyrat e pazgjedhura kthehuni më vonë.

Testi duhet të plotësohet me stilolaps, kurse lapsin e thjeshtë mund ta përdorni gjatë vizatimit të grafikëve dhe figurave gjeometrike.

Nëse gaboni, vizojeni atë dhe punojeni përsëri. Nëse detyrën e keni punuar në më shumë mënyra, shënojeni të qartë versionin që duhet vlerësuar.

Kur t'i kryeni zgjidhjet e detyrave, kontrolloni edhe një herë përgjigjet tuaja.

Detyra do të vlerësohet me 0 pikë nëse:

- ▶ nuk është zgjedhë ose është zgjedhë në mënyrë të pasaktë
- ▶ janë rrethuar më shumë përgjigje të ofruara
- ▶ është e palexueshme dhe nuk është e qartë

Ju dëshirojmë sukses të plotë!

SHIFRA E NXËNËSIT

QERSHOR, VITIT MËSIMOR 2024-2025

FAQJA E ZBRAZËT

FORMULAT

- Katrori i shumës: $(a + b)^2 = a^2 + 2ab + b^2$
- Katrori i ndryshimit: $(a - b)^2 = a^2 - 2ab + b^2$
- Ndryshimi i katrorëve: $a^2 - b^2 = (a + b)(a - b)$
- Shumëzimi i fuqive me baza të njëjta: $a^m \cdot a^n = a^{m+n}$
- Pjesëtimi i fuqive me baza të njëjta: $a^m : a^n = a^{m-n}$
- Rrënja e prodhimit: $\sqrt{ab} = \sqrt{a} \cdot \sqrt{b}$
- Rrënja e herësit: $\sqrt{a : b} = \sqrt{a} : \sqrt{b}$

- Teorema e Pitagorës: $c^2 = a^2 + b^2$
(c – gjatësia e hipotenuzës, a i b – gjatësia e katetave)
- Sipërfaqja e trekëndëshit: $S = \frac{ah_a}{2} = \frac{bh_b}{2} = \frac{ch_c}{2}$
(a , b dhe c – gjatësia e brinjëve, h_a , h_b dhe h_c – gjatësitë e lartësive përkatëse)
- Sipërfaqja dhe lartësia e trekëndëshit barabrinjës $S = \frac{a^2\sqrt{3}}{4}$, $h = \frac{a\sqrt{3}}{2}$
(a – gjatësia e brinjës)
- Sipërfaqja e paralelogramit: $S = a \cdot h_a = b \cdot h_b$
(a dhe b – gjatësitë e brinjëve, h_a dhe h_b – gjatësitë e lartësive)
- Sipërfaqja e rombit: $S = \frac{d_1 \cdot d_2}{2}$
(d_1 dhe d_2 – gjatësitë e diagonaleve)
- Sipërfaqja e trapezit: $S = \frac{a+b}{2} \cdot h$
(a dhe b – gjatësitë e bazave, h – gjatësia e lartësisë)
- Perimetri i rrethit: $P = 2r\pi$, Sipërfaqja e rrethit: $S = r^2\pi$
(r – gjatësia e rrezes)

FORMULAT

- Sipërfaqja e kubit: $S = 6a^2$
(a – gjatësia e brinjës)
- Vëllimi i kubit: $V = a^3$
(a – gjatësia e brinjës)
- Sipërfaqja e kuadrit (kuboidit): $S = 2(ab + ac + bc)$
(a , b dhe c – gjatësitë e brinjëve)
- Vëllimi i kuadrit (kuboidit): $V = abc$
(a , b dhe c – gjatësitë e brinjëve)

Shenjat: B – sipërfaqja e bazës, M – sipërfaqja e mbështjellësit dhe H – gjatësia e lartësisë

- Sipërfaqja e prizmit: $S = 2B + M$
- Vëllimi prizmit: $V = B \cdot H$
- Sipërfaqja piramidës: $S = B + M$
- Vëllimi piramidës : $V = \frac{1}{3} B \cdot H$
- Sipërfaqja cilindrit: $S = 2B + M = 2r\pi(r+H)$
(r – gjatësia e rrezes së bazës)
- Vëllimi cilindrit: $V = B \cdot H = r^2\pi H$
(r – gjatësia e rrezes së bazës)
- Sipërfaqja konit: $S = B + M = r\pi(r+s)$
(r – gjatësia e rrezes së bazës dhe s – gjatësia e përfutjeses-gjeneratrisës)
- Vëllimi konit: $V = \frac{1}{3} B \cdot H = \frac{1}{3} r^2\pi H$
(r – gjatësia e rrezes së bazës)

Në detyrat në vijim rrethoni shkronjën para përgjigjes së saktë.

1.

Cili nga numrat e dhënë i përket intervalit $\left(-\frac{3}{4}, -\frac{1}{3}\right)$?

- A. $-\frac{1}{4}$
- B. $-\frac{1}{2}$
- C. $-\frac{4}{5}$
- D. $-\frac{5}{6}$

1 pikë

2.

Cili operacion duhet të kryhet i fundit ashtu që vlera e shprehjes $2 \cdot (132 - 93) + 507 : (-13)$ të llogaritet saktë?

- A. mbledhja
- B. zbritja
- C. shumëzimi
- D. pjesëtimi

1 pikë

3.

Joni ka paguar sandviçin 8 € dhe lëngun 1 €. Mirani për të njëjtin çmim bleu sallatën dhe akulloren. Sallata është dy herë më e shtrenjtë se akullorja. Sa euro kushtoi sallata e Miranit?


- A. 3
- B. 4
- C. 5
- D. 6

1 pikë

4.

Në kopshtin zoologjik jetojnë 1 000 kafshë dhe mund të ndahen në katër grupe. Përfaqësimi në përqindje për secilën prej katër grupeve, është dhënë me diagram rrethor.

GRUPET E KAFSHËVE NË KOPSHTIN ZOOLOGJIK



Me cilën tabelë janë paraqitur saktë të dhënat nga diagrami rrethor?

A.

Grupi i kafshëve	zvarranikët	peshqit	zogjtë	gjitarrët
Numri i kafshëve	150	170	280	400

B.

Grupi i kafshëve	zvarranikët	peshqit	zogjtë	gjitarrët
Numri i kafshëve	400	280	170	150

C.

Grupi i kafshëve	zvarranikët	peshqit	zogjtë	gjitarrët
Numri i kafshëve	150	400	170	280

D.

Grupi i kafshëve	zvarranikët	peshqit	zogjtë	gjitarrët
Numri i kafshëve	400	150	280	170

1 pikë

5.

Për cilin funksion janë të sakta të dhënat nga tabela?

x	1	2	3
$f(x)$	1	5	9


- A. $f(x) = 3x - 1$
- B. $f(x) = 9 - 3x$
- C. $f(x) = 4x - 3$
- D. $f(x) = 7 - 2x$

1 pikë

6.

Në skicën e mëposhtme është dhënë trekëndëshi $\triangle ABC$ me këndet e brendshme $\alpha = 55^\circ$, $\beta = 75^\circ$ dhe $\gamma = 50^\circ$.

Në cilin raport janë brinjët e trekëndëshit të dhënë



- A. $a < b < c$
- B. $b < c < a$
- C. $b < a < c$
- D. $c < a < b$

1 pikë

Detyrat në vijim të zgjidhen me ecuri. Pikët grumbullohen në bazë të formulimit të saktë, ecurisë së zgjidhjes dhe rezultatit, që rrjedh nga puna korrekte.

7. Llogaritni:

Vërejtje: do të pranohen vetëm zgjidhjet që rrjedhin nga puna me ecuri.

a) $4 \cdot \sqrt{1 + \frac{9}{16}} =$

1 pikë

b) Më poshtë janë çmimet e tre artikujve në shitore.



Jetoni ka blerë dy bukë, një jogurt dhe banane. Sa është fatura e tij?

Zgjidhje:

2 pikë

8.

Nga stacioni i autobusëve në Budva nisen autobusët për Tivar çdo 20 minutë. Autobusi për Igallo niset çdo 16 minutë. Autobusi për Tivar dhe autobusi për Igallo nisen nga stacioni i autobusëve çdo mëngjes në orën 6. Në sa ora, më së pari, sërish do të nisen njëkohësisht autobusët për këto dy qytete?

Zgjidhje:

2 pikë

9.

a) Zbritni polinomet $(-3x^2 + 4x - 7) - (x^2 + x - 5)$.

Zgjidhje:

1 pikë

b) Llogaritni katrorin e binomit $(3a - 4)^2$.

Zgjidhje:

1 pikë

10. Zgjidhni:

a) $\frac{x}{4} - 5 = 7$

Zgjidhje:

1 pikë

b) $8x + 5 \leq 12x$

Zgjidhje:

2 pikë

- 11.** Qëllimi i Jehonës është të kursejë 1 200 euro. Ka vendosur që çdo muaj të kursejë nga 30 % nga paga e saj që është 690 euro. Llogaritni për sa muaj do të arrijë Jehona tek qëllimi.


Zgjidhje:

2 pikë	
--------	--


12.

Me diagram janë paraqitur temperaturat në dy qytete, të matura në orën 14, gjatë pesë ditëve të njëpasnjëshme në janar të vitit 2025. Në bazë të diagrameve të dhëna përgjigjuni në pyetje.

TEMPERATURA (°C) NË ZHABJAK
NË JANAR TË VITIT 2025



TEMPERATURA (°C) NË CETINË
NË JANAR TË VITIT 2025



■ E HËNË ■ E MARTË ■ E MËRKURË ■ E ENJTE ■ E PREMTE

a) Në cilin qytet dhe cilën ditë është matur temperatura më e ultë ?

Përgjigje: _____


1 pikë

b) Sa është dallimi në mes të temperaturës më të madhe dhe më të vogël në Cetinë në periudhën e vëzhguar?

Përgjigje: _____

1 pikë


- 13.** Duke shfrytëzuar të dhënat nga figura, përcaktoni gjatësinë e lartësisë CC_1 të trekëndëshit të dhënë, nëse është dhënë brinja $AB = 10$ cm?



Zgjidhje:

2 pikë

- 14.** Rruga e përditshme e Davidit nga shtëpia te shkolla është dhënë me hartë. Llogaritni gjatësinë e rrugës që Davidi kalon nga shtëpia te shkolla?




Zgjidhje:

2 pikë

15.

Prizmi i drejtë dhe i rregullt gjashtëfaqësh, i ndërtuar nga druri, me brinjë të bazës 2 cm dhe lartësi 8 cm, është prerë në dy gjysma identike, siç është paraqitur me vija të ndërprera në figurën më poshtë. Llogaritni ndryshimin në mes të syprinës së prizmit fillestar dhe syprinës së njërës prej prizmeve të fituar.

**Zgjidhje:**

3 pikë	
--------	--



POPUNJAVA KOMISIJA ZA OCJENJIVANJE

Ukupan broj osvojenih bodova na testu: _____

Ocjena: _____

KOMISIJA:

GLAVNI OCJENJIVAČ:

Dana _____ 20_____. godine